

## KONTRATË PËR SHITJE AKSIONESH

---

ky kontratë është bërë sot me datën e mëposhtme ndërmjet

Zentralbank Österreich AG, Am Stadtpark 9, A-1030 Vjenë (në vijim "RZB")

Raiffeisen International Bank-Holding AG, Am Stadtpark 9, A-1030 Vjenë (në vijim "RI"),

(së bashku në vijim "Palët")

### Hyrje

Duke qenë se RZB ka blerë nga Ministria e Financave e Republikës së Shqipërisë që përfaqëson shtetin shqiptar ("Pronari original") të gjithë aksionet e Bankës së Kursimeve të Shqipërisë, me seli në Rrugë "Deshmorët e 4 Shkurtit", Nr. 6, Tiranë, (në vijim "Banka") sipas kontratës së shitjes së aksioneve (në vijim "Kontrata") më datë 13 janr 2004.

Duke qenë se kapitali i regjistruar i Bankës është 700.000.000,-- (shtatëqindmilionë Lekë Shqiptarë) i shprehur në 7.000 aksione nominative të zakonshme (në vijim "Aksionet") me vlerë nominale 100.000,- Lekë secili.

Duke qenë se RI është një shoqëri holding e rjetit bankar të RZB në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe është plotësisht e zotëruar dhe e kontrolluar nga RZB.

Duke qenë se ky transferim i kapitalit ka si qëllim ruajtjen e strukturës së përgjithshme të zotërimit të Grupit RZB gjithashtu përse i përket zotërimit të aksioneve në kapitalin e Bankës dhe nuk sjell asnjë ndryshim në kontrollin e Bankës, i cili vazhdon të ushtrohet nga RZB.

Duke qenë se transferimi i aksioneve është në përputhje me dispozitat e Kontratës dhe në veçanti me nenin 10.2 të saj.

Duke qenë se Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka dhënë një opinion ligjor që konfirmon se ky transferim është në përputhje me Kontratën dhe se nuk ka arsye për të besuar dhe asnjë informacion apo njohuri të cilat cilësojnë se si Banka e Shqipërisë ashtu edhe Autoriteti i Konkurrencës, nuk do ta japin pëlqimin e tyre.

Tani, në vijim, palët bien dakort si më poshtë:

### I. Transferimi i Aksioneve

Këtu bie dakort të blejë nga RZB dhe RZB bie dakort të transferojë Aksionet e Bankës, së bashku me të drejtat bashkëngjitur tek RI, të lira nga çdo detyrim, barra, pengje apo privilegje.

Vlera e rënë dakort bashkërisht e Aksioneve është EUR 101.449.275,36 (me fjalë: njëqindënjë milionë e katër qindë e dyzetë e nëntë mijë e dyqindë e shtatëdhjetë e pesë pjesë tridhjetë e gjashtë) (në vijim "Vlera").

- (3) Vlera paguhet brenda 3 ditëve pune (çka nënkupton ditët gjatë të cilave bankat në Vjenë janë të hapura për të kryer veprimtarinë e tyre të përgjithshme) pas përmbushjes së të gjithave kushteve paraprake të parashikuara në nenin 2 më poshtë.
- (4) Me kryerjen e pagesës së vlerës, RZB transferon Aksionet tek RI dhe premtun që do të marrë çdo masë të nevojshme me qëllim që të realizojë në mënyrë të plotë dhe të vlefshme transferimin e Aksioneve, duke përfshirë, dhe duke mos u kufizuar vetëm në to, çdo regjistrim të nevojshëm ose dhënien e çdo deklarate ose vërtetimi në lidhje me transferimin.

## 2. Kushtet Paraprake

- (1) Detyrimet e Palëve për plotësimimin e shitblerjes së Aksioneve janë të kushtëzuar nga përmbushja e secilit prej kushteve paraprake të mëposhtme:
  - a) vendimi i Bankës së Shqipërisë për transferimin e aksioneve te RI; dhe
  - b) vendimi i Autoritetit të Konkurrencës së Republikës së Shqipërisë.

## 3. Garancitë dhe Premtimet

- (1) RZB këtu garanton dhe premtun se:
  - a) Aksionet janë të shlyera plotësisht dhe përfaqësojnë aksione të vlefshme në kapitalin e Bankës;
  - b) Aksionet përbëjnë një pronë të lirë nga të gjitha detyrimet, barrat, privilegjet, të drejtat e sekuestrimit, si dhe nga çdo e drejtë tjetër mbi to, të çfarëdolloj natyre;
  - c) Aksionet i transferohen RI, së bashku me të gjitha të drejtat e lidhura me to;
  - d) duke u bazuar në vlefshmërinë dhe saktësinë e të gjithë deklaratave të Shitësit Original, sipas Kontratës, (në vijim "Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit Original"). RZB deklaron se Deklaratat dhe Garancitë e Shitësit Original janë të vlefshme dhe të sakta, dhe se Shitësi Original do të përmbushë të gjithë detyrimet e tij që rrjedhin nga ose janë të lidhura me Kontratën (së bashku me Deklaratat edhe Garancitë e Shitësit Original, në vijim "Detyrimet e Shitësit"), të tilla si marrëveshja

...shpërndarjen e dividendit në lidhje me gjetjen e mashtrimeve në Bankë më datë 15 Prill 2004.

Secila, RZB dhe RI këtu, garantojnë dhe premtojnë se:

- a) secila ka fuqi dhe kompetenca të plota për të lidhur, nënshkruar dhe zbatuar këtë Marrëveshje dhe për të përmbushur plotësisht detyrimet që rrjedhin nga ajo;
  - b) kjo Marrëveshje është e ligjshme e vlefshme dhe detyruese për RZB dhe RI, dhe e ekzekutueshme kundrejt tyre në përputhje me kushtet e saj.
- (3) RZB dhe RI këtu, garantojnë se kjo Marrëveshje dhe përmbushja e detyrimeve të saj nuk bie në kundërshtim me:
- a) ndonjë ligj apo rregullore të zbatueshme për RZB dhe/ose RI respektivisht;
  - b) dokumentat themelues të tyre veçanërisht por duke mos u kufizuar në statutin e tyre;
  - c) çdo marrëveshje, veçanërisht Kontrata, ose çdo dokument tjetër detyrues për to.
- (4) RI këtu, deklaron se ka dijeni të plotë për Kontratën dhe ndërmerr të gjitha detyrimet e mbetura të RZB - në datën e kalimit të plotë dhe të vlefshëm të Aksioneve - , në cilësinë e Shitësit që parashikohen nga neni 10 i Kontratës.

### 3 Zhdëmtimi

- (1) RZB zhdëmton RI për të gjitha dëmet e shkaktuara nga shkeljet e çdo detyrimi të Shitësit Original ose të çdo pale tjetër të lidhur me të.
- (2) Përgjegjësia e parashikuar në pragrafin (1) më lart, kufizohet me shumën që RZB realisht merr nga Shitësi Original ose çdo palë tjetër e lidhur me të, pasi ka bërë përpjekje të arsyeshme.
- (3) Çdo tarifë apo shpenzim duke përfshirë por duke mos u kufizuar në tarifën për konsulencë ligjore të jashtme dhe të brendshme, përballohen nga RI.

### 4 Taksat

- (1) RI do të përballojë të gjitha taksat, shpenzimet dhe detyrimet që duhet të paguhet në lidhje me këtë Marrëveshje.

### 5 Të Ndryshme

... nga dispozitat e kësaj Marrëveshje është e pavlefshme, me përjashtim të ... kur pjesë të fjalive janë fshirë ose ndryshuar, çdo dispozitë e tillë, do të zbatohet ... ndryshimet e nevojshme për ta bërë atë të vlefshme, detyruese dhe të ... me kusht që dispozita e ndryshuar në këtë mënyrë të përputhet me ... dhe qëllimin e kësaj Marrëveshje.

Ajo që vonesë ose mospërbushje në ushtrimin e çdo të drejte, kompetence ose privilegj që rrjedh nga ajo, vlen si dorëheqje prej saj; për më tepër çdo ushtrim i plotë apo i pjesshëm i të drejtave ose privilegjeve që rrjedhin nga ajo, nuk përjashton ushtrimin e mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e çdo të drejte, kompetence ose privilegj tjetër. Të drejtat dhe kompensimet që janë parashikuar shprehimisht këtu, nuk janë përjashtuese të drejtave apo kompensimeve të tjera që palët mund të kenë.

- (3) Kjo Marrëveshje është e dyanëshme ndërmjet palëve. Zbatimi i detyrueshëm i dispozitave të kësaj Marrëveshje mund të kërkohet vetëm nga njëra prej palëve.
- (4) Kjo marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze. Çdo njoftim i bërë sipas kësaj Marrëveshje ose në lidhje me të do të jetë në gjuhën angleze.

#### 6. Ligji i Zbatueshëm - Juridiksioni

Marrëveshja rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Austrisë dhe i nënshtrohet vetëm kompetencave të gjykatave Austriake.

Nënshkruar më 25 Maj 2004

Në emër dhe për llogari të:

Raiffeisen Zentralbank Osterreich AG

Mag. Angelika Weiss  
Nënshkrimi

Dr. Robert Kaukal  
Nënshkrimi

Në emër dhe për llogari të:

Raiffeisen International Bank-Holding AG

Dir. Heinz Hodl  
Nënshkrimi

Mag. Renate Kattinger  
Nënshkrimi

kopje përputhet plotësisht me origjinalin e paraqitur, në tekst ashtu si dhe në shifra.  
Vjena, më 1. (nje) Qershor 2004 (dymijekatër)

Dr. Christoph Bieber  
NOTAR PUBLIK  
me zyrat në Vjenë - Qender  
Vula, Nenshkrimi

PRESIDENTI I GJYKATËS SE LANDIT TË VJENËS  
JV 19037/04

Vertetohet autenticiteti i nenshkrimit i Noterit Publik, Dr. Christoph Bieber  
1040 Vjene, Schwarzenbergplatz 11  
Vjene, më 4 qershor 2004  
Vula, Taksa prej 10 EURO  
Per Presidentin nenshkruan Z. FOI Fabsits  
Nenshkrimi

MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME


Vjene, më 7 qershor 2004  
Nenshkrimi, Taksa prej 16,20 EURO me Nr. Prot: 4819/04

APOSTILLE

(Konventa e Hages, 5 tetor 1961)  
Vjene, më 7 qershor 2004  
Nr. Prot.: 4819/04  
Nenshkrimi, Z. Schwanda  
Vula

Dr. Christoph Bieber  
NOTAR PUBLIK  
Vula

**Përkthyes**

  
\_\_\_\_\_